

**DHOMA E POSAÇME E
GJYKATËS SUPREME TË
KOSOVËS PËR ÇËSHTJE
QË LIDHEN ME
AGJENCINË KOSOVARE
TË MIRËBESIMIT**

**SPECIAL CHAMBER OF THE
SUPREME COURT OF
KOSOVO ON KOSOVO
TRUST AGENCY RELATED
MATTERS**

**POSEBNA KOMORA
VRHOVNOG SUDA
KOSOVA ZA PITANJA
KOJA SE ODNOSE NA
KOSOVSKU
POVERENIČKU
AGENCIJU**

ASC-10-0027

Në padinë e

nga fshati [REDACTED] Komuna e Prishtinës,
përfaqësuar nga Vahid Halili, avokat nga Prishtina
[REDACTED]

Paditësi/Ankuesi

kundër

1. FBI [REDACTED] nga Fushë Kosova

2. NSH [REDACTED] nga Llapna Sella,
Komuna e Prishtinës,

Të Paditurit

Kolegji i Ankesave i Dhomës së Posaqme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit (DHPGJS), i përbërë nga Richard Winkelhofer, Kryetari i DHPGJS-së, si Gjyqtar Kryesues, Torsten Frank Koschinka dhe Eija-Liisa Helin, Gjyqtarë, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 14 maj 2010, lëshon këtë

A K T V E N D I M

Ankesa është e bazuar.

Aktvendimi i DHPGJS-së i datës 11 shkurt 2010, SCC-08-0269, lihet mënjanë.

Trupi Gjykues urdhërohet ta rigjykojë padinë.

Ankuesi obligohet të paguajë tarifat gjyqësore në shumën prej 60 eurove për procedurën ankimore pranë Dhomës së Posaçme.

Trupi Gjykues do të duhet të vendosë mbi shumën e shpenzimeve në procedurën e shkallës së parë dhe ndarjen e tyre në mes të palëve, si dhe ndarjen e shpenzimeve të procedurës ankimore.

Rrethanat faktike dhe procedurale:

Më 10 tetor 2008, Paditësi ushtroi një padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit (DHPGJS), kundër të Paditurve, duke i kërkuar DHPGJS-së ti anulojë kontratat e shitblerjes të pronës së paluajtshme, Vërt. Nr. [REDACTED] i datës 14 korrik 1961 dhe Vërt. Nr. [REDACTED] i datës 20 nëntor 1963, dhe ti obligojë të Paditurit ti kthejnë ngastrat kadastrale nr. [REDACTED]
[REDACTED] të Komunës Kadastrale [REDACTED] në një sipërfaqe të përgjithshme prej 2.98,91 ha, tek Paditësi në ndërrim të çmimit të blerjes.

Me urdhrin e 23 dhjetorit 2009, Trupi Gjykues e urdhëroi Paditësin të paraqesë dëshmi se njoftimi i është dhënë Agjencisë në kohën e duhur në pajtim me Nenet 29.1 dhe 30.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2002/12. Më 13 janar 2010, Dhoma e Posaçme e pranoi parashtresën e ushtruar nga Paditësi me një kopje të bashkëngjitur të njoftimit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP), e cila ishte regjistruar nga AKP-ja më 27 tetor 2008.

Pas kësaj parashtrese Trupi Gjykues, me aktvendimin e tij të datës 11 shkurt 2010 (SCC-08-0269), e refuzoi padinë si të papranueshme për shkak të mungesës së njoftimit të **paraprak** të qëllimit për të parashtruar padinë siç parashihet nga Neni 29.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2002/12, pa dhënë ndonjë arsyetim më të detajuar përveç një citati të thjeshtë të ligjit.

Më 5 mars 2010, paditësi ushtroi një ankesë kundër aktvendimit të lartpërmendur, duke i kërkuar Kolegjit të Ankesave të DHPGJS-së ta shfuqizojë aktvendimin dhe ta kthejë lëndën tek Trupi Gjykues për rigjykim.

Paditësi në padinë e tij pohon për shkelje thelbësore të rregullave procedurale sa i përket zbatimit të Neneve 28.4 dhe 28.2 të UA të UNMIK-ut 2008/6, e lidhur me Nenin 29.1 i Rregullores së UNMIK-ut 2002/12.

Arsyetimi ligjor:

Ankesa është e pranueshme dhe e bazuar.

Kolegji i Ankesave nuk mund ta përcjellë tërësisht Trupin Gjykues (rrjedhimisht duke mos u përputhur me Nenin 9.3 (b) të RREG së UNMIK-ut 2008/4) duke dhënë arsyе se formulimi i Nenit 29.1 i RREG së UNMIK-ut 2002/12 nuk mund të jetë subjekt i interpretimit mbi bazën e marrjes parasysh të ratio legis.

Njoftimi i Agjencisë:

Sipas Nenit 29.1 të RREG së UNMIK-ut 2002/12 (e lidhur me Nenet 28.2 [e], 28.3 të UA të UNMIK-ut 2008/6), njoftimi me shkrim i qëllimit për të parashtruar padi kundër ndonjë ndërmarrje duhet t'i jepet Agjencisë para ushtrimit të padisë. Njoftimi i Agjencisë për qëllimin për të parashtruar padinë është gjithashtu në mesin e kritereve të pranueshmërisë siç është paraparë në Nenin 28.3 të UA të UNMIK-ut 2008/6. Edhe pse kriteret e pranueshmërisë duhet të shqyrtohen sipas detyrës zyrtare, në atë fillim të procedurës gjyqësore (ende pa u përfshirë i Padituri) pretendimi i thjeshtë i Paditësit se ishte dhënë njoftimi i duhur, është – në parim – i mjaftueshëm. Nëse Paditësi pohon (në padi dhe sipas urdhrit në pajtim me Nenin 28.4 të UA 2008/6) se ishte parashtruar një njoftim i duhur, Trupi Gjykues nuk mund ta hedh poshtë padinë si të papranueshme në bazë të kësaj arsyje. Përveç nëse padia është e papranueshme mbi baza të tjera, duhet ti jep të Paditurit mundësinë të marrë një qëndrim mbi njoftimin (e pohuar), bashkë me bazën meritore të lëndës (duke e dorëzuar padinë dhe dokumentet e tjera tek i Padituri; audiatur et altera pars). Më pas i takon të Paditurit t'i kontestojë dëshmitë siç pohohen në padi, duke përfshirë pohimin e (afateve

të) njoftimit. Vetëm nëse i Padituri (me gjasë i përfaqësuar nga Agjencia) e konteston (afatin për) njoftimin, atëherë do të jetë e nevojshme që Paditësi ta vërtetojë njoftimin.

Në rastin në fjalë, i Padituri nuk ka pasur ende mundësi që ta kontestojë njoftimin. Paditësi e ka parashtruar një kopje të njoftimit të datës 27 tetor 2008, por, duke treguar qartë që ishte parashtruar pas parashtrimit të padisë (10 tetor 2008), dhe rrjedhimisht duke mos qenë në përputhshmëri me Nenin 29.1 të RREG së UNMIK-ut 2002/12 në lidhje me Nenin 28.2 (e) të UA 2008/6. Në këto rrethana nuk është shfaqur nevoja e mëtutjeshme për ta përfshirë të Paditurin; pas parashtresës së Paditësit më 13 janar 2010, tashmë ishte e qartë se jo të gjitha kriteret e pranueshmërisë ishin plotësuar në datën e parashtrimit të padisë.

Megjithatë, duhet të merret parasysh këtu se prej 27 tetorit 2008, AKP-ja ishte e vetëdijshme për padinë. Që prej atëherë, ata nuk kanë dashur të hyjnë në procedurën gjyqësore si përfaqësues të të Paditurit. Duke pasur parasysh se qëllimi i njoftimit është që të njoftohet Agjencia për paditë (e mundshme), dhe që tu jepet mundësia atyre që ta marrin çështjen në emër të NSH-së, është e qartë se qëllimi i njoftimit është arritur (në ndërkohë). Në vazhdim, duhet të merret parasysh se detyra e Paditësit ta njoftojë Agjencinë paraprakisht i shton atij një barrë shtesë për sa i përket qasjes në drejtësi, dhe andaj duhet të interpretohet në mënyrën përkatëse. Në rrethanat specifike të lëndës mund të konsiderohet madje edhe një shkelje e të drejtës ligjore, nëse (AKP-ja në emër të) Paditurit tani do të referohej tek njoftimi i paafatshëm. Në këtë situatë të veçantë, Kolegji i Ankesave e konsideron njoftimin e paafatshëm të pa rëndësishëm (për më tutje) sa i përket gjykimit të lëndës, në veçanti duke pasur parasysh se i është dashur më shumë se një vit Trupit Gjyques ta lëshojë një aktvendim mbi pranueshmërisë e padisë (shih gjithashtu aktvendimin e Kolegjit të Ankesave, ASC-09-0072, 29 prill 2010).

Andaj hedhja poshtë e padisë si e papranueshme nuk ishte e duhur. Prandaj aktvendimi i kontestuar nuk mund të vazhdojë dhe se duhet të revokohet.

Trupi Gjykues do të duhet që të merret (përsëri) me padinë, duke u përbajtj nga hedhja poshtë e sërishme duke u bazuar në të njëjtat baza.

Taksat gjyqësore / shpenzimet:

Sipas Nenit 11 të RREG 2008/4 dhe Nenit 66 të UA të UNMIK-ut 2008/6, Trupi Gjykues duhet të vendosë lidhur me caktimin e shpenzimeve të procedurës gjyqësore të shkallës së parë, dhe Kolegji i Ankesave – kur përfundimisht do të vendosë mbi lëndën – për caktimin e shpenzimeve të procedurës gjyqësore në të dyja shkallët. Lënda në fjalë duhet të rigjykohet në shkallën e parë; andaj, asnjë aktvendim mbi çfarëdo caktimi për shpenzimet nuk mund të merret në ndërkokë, pasi që ky caktim varet nga aktvendimet e ardhshme të Trupit Gjykues. Tani për tani, vetëm shuma e taksave gjyqësore në shkallën e dytë mund të përcaktohet:

Në bazë të Nenit 57.2 të UA të UNMIK-ut 2008/6, Dhoma e Posaqme ka lëshuar Rregulla Procedurale Shtesë lidhur me Taksat Gjyqësore, në fuqi nga 10 marsi 2010. Ato theksojnë si në vijim:

'Neni 10 i Urdhëresës Administrative Nr. 2008/2 mbi Unifikimin e Shpenzimeve të Gjyqit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës i datës 27.11.2008, sa i përket "Tarifave të Shpenzimeve të Gjyqit", me anë të kësaj – me specifikat e mëposhtme – deklarohet të jetë i zbatueshëm për procedurat gjyqësore pranë DHPGJS-së.

Neni 10.9 deri tek Neni 10.23 janë – mutatis mutandis – të zbatueshëm për procedurën ankimore pranë Trupit Gjykues dhe pranë Kolegjit të Ankesave.

Si sqarim, Neni 10.11 gjithashtu zbatohet edhe për procedurën e cila e rregullon ankesën kundër aktvendimeve të shkallës së dytë të Trupit Gjykues.

(...)

Këto Rregulla Procedurale Shtesë hyjnë në fuqi më 10 mars 2010 dhe janë të vlefshme deri më 31 dhjetor 2010.'

Shpenzimet e Gjyqit në të dyja shkallët përbëhen nga njëra anë e prej tarifës për parashtrimin e parashtresës (parashtresave), e në anën tjetër prej tarifës për lëshimin e aktvendimit (aktvendimeve).

Sic u tha më lartë, do t'i takojë Trupit Gjykues të vendosë mbi shumën e shpenzimeve të gjyqit në shkallën e parë, të përbërë nga dy komponentet, si dhe caktimi i tyre.

Sa i përket procedurës së ankesës:

Shuma e tarifës për parashtrimin e ankesës sic përcaktohet nga Neni 10.11 i Urdhèresës Administrative të Këshillit Gjyqësor të Kosovës Nr. 2008/2 mbi Unifikimin e Shpenzimeve të Gjyqit ("ADJ") është 30 euro.

Neni 10.15 i ADJ-së thekson se për aktvendimet që hedhin poshtë paditë (si të papranueshme) vetëm gjysma e shumës së tarifës sic ceket në Nenin 10.1 të ADJ-së (që në parim i bazon shpenzimet e gjyqit në vlerën e padisë) duhet të paguhet, deri në maksimumin prej 30 eurove. Kjo gjithashtu vlen edhe për aktvendimet e shkallës së dytë (Neni 10.21 ADJ i referohet Neneve 10.12 deri në 10.18 të ADJ-së). Neni 10.15 i lidhur me Nenin 10.21 mbulon aktvendimet në shkallën e dytë duke hedhur poshtë ankesat si të papranueshme, si dhe aktvendimet për ankesat kundër aktvendimeve të shkallës së parë të cilat nuk prekin bazën meritore të lëndës.

Përveç nëse vlera e padisë vërtetohet të jetë më e vogël (në shkallën e parë nga Paditësi, në shkallën e dytë nga Ankuesi), sipas Nenit 10.1 i lidhur me Nenet 10.15 dhe 10.21, shpenzimet e gjyqit janë 30 euro.

Në rastin në fjalë, as në shkallën e parë dhe as në atë të dytën nuk janë bërë deklarata për sa i përket vlerës së padisë. Shpenzimi i gjyqit për aktvendimin në shkallën e dytë prandaj përcaktohet të jetë 30 euro.

Si rrjedhojë, përfundimisht zbatohen shpenzimet e vijuese të gjyqit për procedurën ankimore:

Tarifa e Shpenzimit të Gjyqit Neni

10.11 (parashtrimi i ankesës)	30 Euro
-------------------------------	---------

Tarifa e Shpenzimit të Gjyqit Neni

10.15 i lidhur me 10.21 dhe 10.1	
----------------------------------	--

(aktvendimi në shkallën e dytë)	30 Euro
---------------------------------	---------

Gjithsejtë	60 Euro
------------	---------

Këto shpenzime të gjyqit paraprakisht do të barten nga Ankuesi i cili si rrjedhojë obligohet t'i paguajë shumën e përmendur Dhomës së Posaçme (shih Nenin 2 [1] Ligji për Shpenzimet e Gjyqit, Gazeta Zyrtare e Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës e 3 datës tetor 1987).

Do t'i takojë Trupit Gjykues t'i caktojë këto shpenzime të procedurës ankimore në mes të palëve, së bashku me aktvendimin në shkallën e parë, duke përfshirë aktvendimin për shpenzimet (në të ardhmen) të shkallës së parë.

Richard Winkelhofer, Gjyqtari Kryesues i EULEX-it _____ nënshkruar _____

Torsten Frank Koschinka, Gjyqtar i EULEX-it _____ nënshkruar _____

Eija-Liisa Helin, Gjyqtare e EULEX-it _____ nënshkruar _____

Tobias Lapke, Regjistrues i EULEX-it _____ nënshkruar _____

_____ nënshkruar _____